



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 141, datë 22.04.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PËRHAPJEN E COVID-19 GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 147/1, 147/a, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61 pika 2, shkronja “f” dhe “i” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në Udhëzuesin për “Rekomandime të përgjithshme ndaj subjekteve të biznesit që lejohen të zhvillojnë aktivitetin në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Covid-19”, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në propozimin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor”,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullore për marrjen e masave kufizuese për përhapjen e Covid – 19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR